



Autor: Sabahudin Hadzialic

Përktheu në shqip: Albina Idrizi

Një reportazh i pahulumtuar dhe i pakërkuar, krejt i rastësishëm

A MUND TË ËNDËRROHET ZGJUAR?

'Ai i cili dëshiron të jetë pëllumb, duhet, në fillim, të ndërtojë follenë sa më lartë' S. H.

Vërtet, me vite të tëra, së paku ne nga vendet e ish shtetit të përbashkët i cili pa ndonjë rezultat u përpoq të rivendosej në tri baza, ishim të ngarkuar me paragjykime ideologjike për Shqipërinë e Enver Hoxhës. Vendin pa ardhmëri dhe më të vërteta të manipuluar. Për të ndodhur pastaj, zgjimi, si në Shqipëri ashtu edhe në pjesët e ish Jugosllavisë. Por edhe ky zgjim nuk ishte i njejtë varësisht vendeve të krijuara në hapësirat ku himni ' Hej Slaveni' ishte i detyrueshëm brenda një bashkim - vëllazërimi sipërfaqësor, edhe për ata të cilët nuk kishin asgjë të përbashkët me Slavenët, asgjë fare. Gjithsesi, ky është një tregim përkujtues për një analizë më të thellë historike.

Le të përpiqemi të përqëndrohemi kah zgjimi i cili në këto hapësira për disa ishte i dhimbshëm e për disa të tjerë, jo. Për të tretët ishte një gjendje sipërfaqësore

eutanazije, e për të katërt tmerrësisht i gjakosur. Të pestët kanë pritur zgjidhjen pas këndeve të shpresës përderisa të gjashtët, ashtu si pishitari në stemën shtetërore që iku në utopi, digjeshin duke pritur më kot...

Po jua lë juve, lexues të nderuar, të zgjidhni për veten tuaj çfarë më shumë ju përgjigjet nga të lartëpërmendurit, e unë po shkoj të ëndërroj zgjuar...

Urtia e të shpresuarit

Të fillosh një reportazh i ngarkuar përplot paragjykime, është tejet e vështirë. Por, në anën tjetër, të përshkruash gjërat përmes fakteve të rralla që gëlojnë mu para teje, është shumë e lehtë. Duke i parë me sytë e tu, duke i dëgjuar me veshët e tu, duke i ndjerë me të gjitha shqisat e tua.

Shqipëria është vend i shpresës. Cilës do të pyeteni ju? Po asaj shprese e cila ishte shuar në vendet e tjera. Të jetë kjo për shkak se kishin të bëjnë me një shtet relativisht të ri i cili pikërisht këtë vit shënon 100 vjetorin që kur baballarët e kombit nënshkruan dokumentin e pavarësisë në Vlorë?! Të jetë kjo për shkak se plot dyzet vite u akumuluan në mënyrë që të zbrazeshin në një eksplozim shpresash dhe mundësish të së sotmes?! Të jetë kjo për shkak se, si pasaardhës të ilirëve e ndjenë se, më në fund, ishte koha që edhe ky popull të vetëdijësohet ...?! Anise populli më i vjetër, po pra Sllavenët e mij të dashur, populli më i vjetër i gjallë në këto hapësira, të cilin ne, pikërisht ne Sllavenët (të Jugut sidomos) u kemi shumë borxh. Ka shumë pyetje përgjigja e të cilave gjendet në vetë titullin e këtij reportazhi e të cilin unë as që kam filluar ta shkruaj akoma. Përse? Sepse tek unë, vizioni i së vërtetës gjatë ballafaqimit me realitetin u shkri në një valë të ngrohtë shprese mos e gjitha ishte vetëm një mjegullnajë e verbër me të cilin kishim jetuar gjer tani. Dhe me këtë nuk dua të paragjykoj gjërat, jo. Vetëm se, ajo që pashë gjatë këtij udhëtimi një javor nëpër trojet e Shqipërisë etnike nuk kishte të bënte aspak me ndonjë vajtim për të humburën... Nuk kishte të bënte aspak me etjen dhe pangopësinë për të huajën... Nuk kishte të bënte aspak me akuzimin e tjetrit... Nuk kishte të bënte me hipokrizinë e synimeve gllabëruese vetjake... Nuk kishte të bënte me...

Ishte krejtësisht ndryshe. Po çfarë?

Shqipëria, ana e ndritshme e saj

Ka njëzet vite që Shqipëria doli nga utopia e errët komuniste. Sot ajo ka 500 kilometra autostradë a cila diku diku ndërprehet në pjesë të shkurtëra për ti lënë vend pamjeve befasuese të një vendi të mrekullueshëm. Ndërprerje këto që të ngjajnë në jehona të largëta të mendime të zymta tek ikin, ikin,...

Bosna dhe Hercegovina ka vetëm 40 kilometra autostradë të cilën vazhdon ta ndërtojë mbi dhjetë vjet, thuaja krenare në amullinë demokratike që po e jeton. Përderisa qeveritarët e saj kënaqen së jetuari me ngjyrat e gjelbëra, të kuqe dhe të kaltra duke krijuar kështu ylberin e qëllimeve të paskrupullta egoiste drejt humbjes dhe dështimit, qofshin ata majtistë apo djathtistë në qarqet politike.

Shqipëria është vend me një hoteleri¹ të në zhvillim të hovshëm. Mbyllini vetëm për një çast sytë dhe mendojeni veten në një dhomë të pajisur me aparatit klimatik, banjo luksoze dhe shërbyes të njerëzishëm. Mendojeni një asortiman të begatë ushqimesh dhe pijesh. Diell dhe det. E jo, nuk është kjo Monte Carlo, as Nice, aq më pak Napuli, Budva apo Spliti. Fjala është për Sarandën². Qytetin e vogël në jug të Shqipërisë 711³ kilometra larg prej pikës më veriore të këtij vendi.

I zgjuar nga errësira ku ishte katandisur, ky shtet shpërthen duke lulëzuar në të gjitha ngjyrat e mundshme me gjithë virgjërinë e tij joshëse. Por, nuk duhet të gënjehemi. Sikur edhe çdo shtet tjetër në të ashtuqejturin 'tranzicion' edhe këtu egzistojnë akoma mbeturinat e kapitalizmit të parë, shoqërisë post-feudale të cilën e njohin vetëm qeveritarët. Megjithatë, siç e pashë edhe vetë, e ndjeva, e dëgjova,, kjo këtu nuk ka edhe aq rëndësi. Askund nuk pashë fytyra të pikëlluara. Dhe të jeni të bindur se nuk kam vizituar vetëm pjesët e parapara për shtresën e lartë. Isha në restorantet klasike të fast-food po edhe në ato high-class. Mes tyre dallonte vetëm mënyra e prezentimit të prodhimeve. Kualiteti ishte pothuaj tërësisht i ngjashëm.

¹Info: <http://albania-hotels.edialtour.com/hotels/albania/city/29/gj/gj2/title/Hotels-in-Saranda-Albania>

² Saranda numëron afër 40.200 banorë(2004) dhe përbëhet nga dhjetë komuna, gjegjësisht pjesa më e madhe e rrethit të Valonës.

³ Është e nevojshme të rregullohet rruga nga Himara në Sarandë, por tekefundit edhe Franca e Kroacia posedojnë rrugë të tilla e megjithatë nuk na pengojnë të shkojmë.

Kur shpresa buzëqesh

Buzëqeshja në fytyrat e vendasve, jo rrallë më kujtonte hapësirat e vendbanuara me Slavenët, Jugorët e adriatikut të përmendur në nismën e këtij rrëfimi, të cilët shpeshherë të mbjellin atë ndjenjën se më mirë do të ishte t'ua dërgonin numrin e llogarisë bankare për të paguar qëndrimin e pushimit e të mos shkoje fare. Vetëm do tu pengoje, apo jo?

Këtu, në Shqipëri, nëse ndodh ta harroni miun e palidhur të laptopit tuaj në tavolinën ku para pak çastesh keni shikuar për herë të fundit e-maillet tuaja, vetë kryepersoneli i restorantit do të vrapojë pa frymë pas jush 200 metra duke thirrur... 'Mister, mister...' për t'ju dhënë sendin e harruar me buzëqeshje në fytyrë e për të të lënë pastaj pa fjalë nga mahnitja. Në Bosnë dhe Hercegovinë, të njëjtin do ta vendosnin diku në ndonjë raft për të pritur të ktheheshe pas tij.

Çmimet janë 'halo Bing, kako brat'⁴,... imtësira. Në kafeja është 1.5 euro, çmimi ky që i përgjigjet një çmimoreje normale Sarajevase. Birra me emrin domethënës 'Tirana' përputhet jo vetëm për nga sinonimi dhe kualiteti por edhe çmimi i arsyeshëm me tonën, Sarajevase. Pra, mirë dhe lirë. Kazinot egzistuese në Shqipëri, me oferta të llojllojshme nate duke u nisur nga disko klubet, janë **conditio si ne qua non** të këtushme. Galeritë, si ato private ashtu edhe ato shtetore, me ekspozita artistësh të njohur e të panjohur, përditë e më shumë marrin botëkuptimin e llojit inspirativ që nga galeritë e arteve aplikative e deri te galeritë satirike... Hotelet prej dhjetra dhomash çmimet e të cilave varojnë mes 20 dhe 40 euro për gjysëm pansion deri te ato dhjetëkatëshe që shkëlqejnë nga dirtaret e blinduara ngjyrash të ndryshme ku çmimet nuk kalojnë 85 euro për një gjysëm pansion ditor. Shiriti bregdetar i qytetit i rregulluar bukur, përfaqon i gjithi **Porto Edun**⁵, të krijon mundësinë që nga dhoma ku gjendesh të zbresësh menjëherë tek rreshti i parë i lokaleve për të ngrënë mëngjesin... pastaj vazhdon nëpër radhën e kafiterive dhjetra metra më larg, dhe pas kafesë, në dhjetra metra të tjerë mund të zgjedhësh çadrën dhe shtratin për rrezitje mu në mes të plazhit. Dhe krejt këto pa

⁴ Një sentencë e njohur nga ilustrimet e Alan Fordit (Maks & Bunker)

⁵ Kështu quhej kjo pjesë në kohën e Italisë Musoline

ndarë për asnjë çast shikimin nga deti i bukur dhe i qetë i Jonit ku pasqyrohen malet e afërta të Greqisë me Korfuzin përballë.

Saranda, me autobus është larg Bosnës dhe Hercegovinës plot 20 orë... por, besomëni që e vlen edhe aq, ndonëse autori i këtyre rreshtave është mësuar të udhëtojë me aeroplan nga Sarajeva nëpërmjet Oslos deri në Vankuver dhe mbrapa, nëpërmjet Cyrihut, Vjenës, Romës, Zagrebit, Beogradit dhe më tej. Është e qartë që për këtë largësi nuk duhet fajësuar banorët e Shqipërisë por duhet treguar qeveritarëve shtetërorë të Bosnës dhe Hercegovinës e edhe atyre të Shqipërisë, se duhet bërë sa më shpejt diçka lidhur me këtë. Imagjinoni një vend që nuk ka lidhje komunikuese me shtetin më të afërt të saj. Madje as nga Podgorica e Malit të Zi nuk ka lidhje autobusi me Shqipërinë. Në Sarajevë, megjithatë, ekzistojnë individë, të cilët bartin personelin e Ambasadës Shqiptare në Bosnë dhe Hercegovinë, Ulqin e gjer në kufirin mes Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ata pastaj hidhen në Shkodër dhe vazhdojnë për Tiranë. Kështu, në interes të të dy palëve është i domosdoshëm krijimi i një linje të rregullt autobusësh gjë kjo e cila më së shumti rëndon ndërgjegjen e kompanive turistike dhe autotransportuese për heshtjen e thesareve dhe resurseve natyrore mu në afërsi të kufirit bosnahercegovanas teksa na ofrojnë Kubën dhe lundrimet tejoqeanike, e po kjo vlen njësoj edhe për fqinjët tanë nga Shqipëria.⁶

Po duke mos qenë as kundër këtyre udhëtimeve, unë vetëm dua të shtoj se ‘ nga drunjët nuk po e shohim malin’. Bëjmë mëkat të madh sepse, edhe pse në dukje larg, Shqipëria në të vërtetë është shumë afër.

‘Ecë rrugës Latif aga me jaranë...’

Sikur të udhëtonit me autobus nga Sarajeva në Prishtinë nuk do të bënit keq të kthenit në Novi Pazar për një kafe shtëpie, me mikun dhe kolegun Mexhid

⁶]Natyrisht, ekzistojnë ture turistike private por është e nevojshme dhe më se e dobishme të krijohen lidhje të rregullta që do të lidhnin këto vende. Propozim: Sarajevë-Podgoricë-Tiranë-Athinë, nëse është e mundur të shqyrtohen nevojat dhe mundësitë e përbashkëta

Mehmeti të vizitonit Prekazin dhe vendvrasjen e Adem Jasharit, luftëtarit të denjë për pavarësinë e Kosovës, pastaj Tyrben e Sultan Muratit i cili vritet në Fushë Kosovë bashë me Car Lazarin (1389). Më tej të merrni rrugën për Prizren dhe Tiranë, duke kaluar plot dashamirësi kontrollin kufitar dhe me përshtypjen se jeni duke përshkuar tunelin i cili ndan Francën me Italinë, në më pak se tri orë (në vend të shtatë orëve dikur), sakaq gjendesh në plazhin e mrekullueshëm të Durrësit në Shqipëri. Aty pi kafënë dhe vazhdon kah Vlora duke vizituar ‘Shtëpinë e Baballarëve të Kombit’ e duke lozur me shikim mbi Mediteran, nëpër valët e Adriatikut e gjer tek deti Jon, në jug. Dhe, nëse ju them se gjatë këtij udhëtimi gjithnjë të shoqëruar me personelin dashamirës të agjensisë Sharr Travel nga Prishtina i cili na ofroi ëmbëlsira dhe pije freskuese falas përgjatë rrugës, në krejt pak vende kam parë bunkerë të vegjël, relike të së kaluarës së errët të dyzet viteve, nuk ju gënjej aspak.

Suvenirët përreth bregdetit qëndronin mes kiçit klasik dhe modeleve kërkuese të kohës. Qetësia dhe paqja me të cilën vendasit duan t’ju ndihmojnë është pothuaj ireale. Aq e pabesueshme sa jo vetëm njëherë jam pyetur mos vallë jam diku tjetër e jo në Shqipëri, vendin e errësirës dhe makthit të dikurshëm.

Pastaj, vendasit do t’ju shpiejnë në Butrint⁷, dhjetra minuta tej Sarandës, qytetin historik për të cilin egzistojnë versione të ndryshme nga ana e historianëve shqiptarë dhe atyre grek. Do të ishte mirë të gjindet një kompromis mes dy palëve.

Epilogu *si mouve*

⁷ Qyteti i Butrintit ishte i banuar që nga parahistoria, një kohë ishte edhe koloni greke, qytet romak dhe seli peshkopësh. Kulmin e zhvillimit të tij e arriti më shek IV para Krishtit, kur numëronte rreth 10.000 banorë. Nga kjo kohë janë të ruajtura mure ciklopi (6m), akropoli, teatri dhe tempulli i Asklepit, si dhe qindra mbishkrime në greqishten e vjetër. Pasi mbijetoi vitet e prosperimit të Mbretërisë Bizantine, për një kohë të shkurtër u okupua nga Mlečanët 1386 (shën. i autorit). Lirohet nga gjysma e dytë e shekullit të mesëm kur brenda tij krijohet një kënetë e cila dalëngadalë po pushtonte qytetin dhe kërcënonte të sëmuret. Përsëri e zbulojnë arkeologët italianë I. Ugolini, P. Marconi dhe D. Mustili, të cilët inicuan gërmime sistematike nga viti 1928 e deri në vitin 1941, gërmime këto që u përfunduan nga arkeologët shqiptarë pas Luftës së Dytë Botërore. Është vërtetuar se llumi dhe vegetacioni i kënetës ka mbrojtur monumentet e çmuara. Ky vend arkeologjik sot është përplot mbetje ku secili prej tyre paraqet një periudhë të caktuar kohe nëpër të cilën u zhvillua ky qytet. Info: <http://hr.wikipedia.org/wiki/Butrint>

Natyrisht, dikush edhe mund të pyetet: Si është e mundur? Është i shitur ky autor? Kush ia pagoi rrugën? Kush e frymëzoi me këtë vizion inspirues?

Përgjegjja është shumë e thjeshtë dhe e qartë. Pa pasur qëllimin të shkruaj reportazh, jam nisur si një pjesëmarrës në Festivalin e Poezisë në Sarandë ku u tubuan mbi dyzet poetë nga 16 vende të ndryshme të botës, i ftuar nga miku dhe kolegu Bardhyl Maliqi. Por, ky është një tregim më vete, i bukur, i sinqertë dhe tërheqës, të cilin mund ta shihni në *www.faqet DIOGEN pro kultura magazina*, duke u kënaqur me pamjet fotografike dhe filmike të këtij manifestimi.

Ky tregim, para së gjithash, për njeriun i cili ka vizituar shumë vende nga të gjitha anët e botës, mund të jetë gjithçka tjetër vetëm jo ëndërr. Jo ëndërr në Shqipëri.

Edhe diçka. Do të doja ta përsërisja prapë. Të ëndërroj i zgjuar. Po...

Sabahudin Hadžialić

Editor in chief

DIOGEN pro culture magazine

28.6.2012.

PR

DIOGEN pro kultura
<http://diogen.weebly.com>